

Në bazë të nenit 113 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit mbi vetëqeverisjes lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", nr. 02/18, 34/19 dhe 38/20), e në lidhje me nenin 5 të Vendimit mbi organizimin mbi mënyrën e punës së administratës lokale të Komunës së Tuzit ("Fleta Zyrtare e Malit të Zi – dispozitat komunale", nr. 043/20) dhe Vendimit mbi fillimin e procedurave për plotësimin e vendit të punës, numër 05-032/21-1269 prej më 03.02.2021, Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burimet njerëzore, sh p a ll

## KONKURS TË BRENDSHËM

### për nevojat e Sekretariatit për finansa të Komunës së Tuzit

**1. Këshilltarë/e i/e pavarur I për përcaktimin, pagesën dhe kontrollin e të ardhurave lokale publike – Sektori për të ardhurat lokale publike**

- Ekzekutues: 1, në kohë të pacaktuar
- 240 kredi ECTS (Niveli i VIII i kualifikimit shkollor);
- fakulteti ekonomik;
- së paku pesë vite përvojë pune;
- provimi profesional për punë në organet shtetërore;
- njohja e punës në kompjuter.

#### Dokumentacioni i nevojshëm:

- formulari i paraqitjes për vendin e lire të punës (Formularin e paraqitjes për vendin e lire të punës kandidatët mund ta nxjerrin në web faqen e Komunës së Tuzit [www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me) ose drejtpërdrejt në arkivin e Komunës së Tuzit),
- Curriculum Vitae – CV,
- fotokopja e letërnjoftimit biometrik,
- diplomë ose vërtetim mbi përfundimin e nivelit dhe llojit të arsimit
- vërtetimin e gjyqit kompetent se kundër kandidatit –es nuk zhvillohet procedure penale sipas detyrës zyrtare,
- dëshmi (vërtetim/miratim) mbi përvojën e kërkuar të punës,
- vërtetim mbi provimin e dhënë profesional për punë në organet shtetërore.

Kandidatët mund tja dorëzojnë kopjen e dokumentacionit të lartpërmendur Zyrës për burimet njerëzore, përderisa origjinalin janë të obliguar tja japin në shikim zyrtarit të autorizuar të Zyrës për realizimin e shpalljes.

Bashkëngjitur me fletëparaqitje në konkurs është e nevojshme të dorëzohet specifikimi i dokumentacionit shpallës në të cilin është e domosdoshme të theksohet numri i dokumentit, data e lëshimit dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin i cili dorëzohet në Zyrën për burime njerëzore (Formulari i paraqitjes me vështirësi të dokumentacionit mund të merret në faqen e internetit të Komunës së Tuzit, [www.tuzi.org.me](http://www.tuzi.org.me) ose drejtpërsëdrejti në arkivin e Komunës së Tuzi).

Në konkurs të brendshëm mund të paraqitet zyrtari lokal i cili ka lidh marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, inspektori kryesorë dhe personi zyrtarë kryesorë i autorizuar, personi nga neni 128 paragrafi 2 i Ligjit mbi vetëqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ", nr.02/18, 34/19 dhe 38/20) si dhe personi të cilit i ka pushuar mandati me skadimin e mandatit, në kërkesë personale, me shkëputjen e organit të administratës lokale, shërbimit profesional, gjegjësisht shërbimit të veçantë ose pjesës së punëve që nuk ndërmerr organi tjetër ose shërbimi ose nëse vendi i punës së tij do të ndërpritet me sjelljen e aktit të ri ose ndryshimin e atij ekzistues mbi sistematizimin dhe organizimin e brendshëm.

Me organin shtetëror nuk mund të lidh vend pune personi i cili është përdorues i të drejtës në pension, në pajtim me ligjin.

Zyrtari lokal i cili është në punë të provës nuk ka të drejtë të paraqitet në konkurs të brendshëm.

Verifikimi i dijes, aftësisë, kompetencave dhe shkathtësive, varësisht prej kategorisë së vendit të punës do të bëhet në pajtim me nenin 115 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 02/18, 34/19 dhe 38/20) dhe me Rregullore për kriteret dhe metodën më të afërt të kryerjes së vlerësimit të njohurive, aftësive, kompetencave dhe aftësive për të punuar në organet shtetërore ("Fleta Zyrtare e MZ", numër 50/18).

Testimi në formë të shkruar përbëhet nga pjesa teorike dhe ajo praktike dhe nënkupton hartimin e testit të shkruar.

Verifikimi i dijes së daktilografisë, informatikës ose gjuhës së huaj bëhet në pajtim me rregullat, gjegjësisht standardet në këto fusha.

Testi i shkruar hartohet në formë elektronike, me shifër.

Mbi datën, vendin, dhe mënyrën e verifikimit, të kandidatëve nga lista, kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e shpalljes publike do të jenë të njoftuar përmes ueb faqes së Komunës së Tuzit, më së largu pesë ditë para ditës së verifikimit.

Dokumentacioni i kërkuar është i nevojshëm të dorëzohet në afat prej 15 ditëve nga dita e shpalljes së konkursit publik në zarf të mbyllur (në të cilin është e nevojshme të shkruhet: emri dhe mbiemri, adresa, kontakt telefoni, emri i organit dhe vendi i punës) në adresën:

**Komuna e Tuzit**  
**Sekretariati për vetëqeverisje lokale - Zyra për burime njerëzore**  
**Me shënim: për Konkurs të brendshëm për nevoja të Sekretariatit për finansa të Komunës së Tuzit**

Kontakt tel: +38220875167;

